

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve në administratën shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10, 51/11), dhe Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” 96/19 dhe 110/19) si dhe në bazë të nenit 50 paragrafi 6 të Ligjit për arsim fillor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 161/2019), ministri i Arsimit dhe Shkencës e përcaktoi programin mësimor të shkurtuar për lëndën mësimore Fizikë për klasën IX (nëntë) në arsimin fillor nëntëvjeçar për vitin shkollor 2020/2021.

1. Hyrje

Programi i shkurtuar mësimor nga lënda mësimore e Fizikë për klasën e IX (nëntë) nga arsimi fillor bazohet në qëllimet/ rezultatet e pritura të parapara me programin mësimor për lëndën mësimore i cili realizohet si i rregullt në përputhje me planet mësimore të verifikuara.

Me programin e shkurtuar vërtetohen temat e caktuara të cilat do të duhen të realizohen për 159 ditë mësiomore, gjatë së cilës duhet patur kujdes fondi i paraparë në kuadër të programit të rregullt, konkretisht me 2 orë në javë parashihen 64 orë në programin e shkurtuar.

Arsintari gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar mësimor niset nga qëllimet /rezultatet e pritura, nocionet e caktuara, metodat dhe aktivitetet të verifikuara në programin e rregullt mësimor.

2. Pasqyrë e temave dhe njësitë mësimore

Tema 1 - FORCAT DHE LËVIZJA (14 orë) (11+ 3)

Njësitë mësimore

1. Hyrje në leva,
2. Studimi i luhatësve
3. Balancimi i lëkundësve
4. Zbatimi i parimit të momenteve
5. Hyrje në dendësi,
6. Përcaktimi i dendësisë me kuadra/ kuboide dhe materiale të ngurta
7. Arkimedi dhe Kurora e Artë
8. Dendësia e lëngjeve dhe gazrave
9. Shtytja
10. Llogaritja e presionit
11. Llogaritja e presionit në gazra dhe lëngje

Tema 2 - ENERGJIA (14 orë) (10+ 4)

Njësitë mësimore

1. Çfarë është "nxehtësia"?
2. Përcjellja e nxehtësisë - kondukcioni,
3. Përcjellja e nxehtësisë - konvekzioni
4. Përcjellja e nxehtësisë - radiacioni
5. Zvogëlimi i humbjes së nxehtësisë
6. Qëndrimi i ftohtë - avullimi
7. Lëndët për djegie
8. Energjia e rrinovueshme
9. Përdorimi i energjisë në botë
10. Energjia për një ishull

Tema 3 - Elektriciteti dhe magnetizmi (20 orë) (15+ 5)

Njësitë mësimore

1. Forca të padukshme
2. Çfar janë bateritë
3. Elektrostatika rrëth neshë
4. Ndërtimi i qarqeve elektrik
5. Matja intenzitetit të rrymës në qarqet elektrik serike
6. Matja e rrymës në qarqet elektrik serik me numër të ndryshëm të baterive
7. Matja e rrymës në qarqet elektrike paralele
8. Studimi i rezistencës
9. Hyrje për tensionin

10. Tensioni në qarqet serike dhe paralele
11. Tensioni në qarqet paralele
12. Karakteristikat e magnetëve
13. Fushat magnetike
14. Elektromagnetët
15. Demagnetizimi

Tema 4 - Tingulli (16 orë) (9+ 7)

Njësitë mësimore

1. Lëkundjet dhe tingulli
2. Lëvizja e grimcave të ajrit
3. Lartësia e frekuencës
4. Zërimi (intenziteti) dhe amplituda
5. Vizualizimi i valëve të zërit në një osciloskop
6. Valët e zërit përcjellin energji
7. Rreziqet e tingujve me energji të lartë
8. Reflektimi valëve të zërit
9. Matja e shpejtësisë së valëve të zërit

3. Rekomandimet didaktike

Me programin e shkurtuar për lëndën e Fizikës klasa e IX (nëntë) për arsimin fillor, janë përfshi tema të caktuara dhe njësi mësimore të programit të rregullt që janë të ndërlidhura reciprokisht dhe formojnë një tërësi logjike. Në pjesën *Përbledhje e temave dhe njësive mësimore* cekën temat e përcaktuara nga programi i shkurtuar dhe njësitë mësimore që i referohen zhvillimit të përbajtjeve të reja mësimore. Për secilën temë jepet numri i përgjithshëm i orëve që do të realizohen. Duke qenë se renditen njësitë mësimore që i referohen zhvillimit të përbajtjes së re mësimore, numri i mbetur i orëve brenda temave që mësuesi planifikon, organizon dhe zbaton si orë për përsëritje, verifikim, ushtrime, kontroll të njohurive të nxënësve, sistematizim, hulumtim, etj.

Në temën **Forcat dhe Lëvizja** është propozuar të bashkohen:

Përcaktimi i dendësisë me kuadra/ kuboide dhe materiale të ngurta

Presioni i gazit dhe presioni i lëngut

- Në temën **Energjia** nuk ka bashkim të përmbajtjes, vetëm orë të reduktuara në ushtrime dhe rekomandohet që gjatë përpunimit të përfshihen konceptet themelore të këtyre njësive mësimore.

- Në temën e **Elektriciteti dhe magnetizmi** nuk ka asnje bashkim të përmbajtjeve, vetëm orë të reduktuara në ushtrime dhe rekomandohet që konceptet themelore të këtyre njësive mësimore të përfshihen gjatë përpunimit

- Në temën **Tingulli** nuk ka asnje bashkim të përmbajtjes, vetëm orë të reduktuara në ushtrime dhe rekomandohet që konceptet themelore të këtyre njësive mësimore të përfshihen gjatë përpunimit

Zgjedhjen dhe kombinimin e metodave, formave dhe procedurave specifike në mësimdhënie, mësuesi bën drejtpërdrejt kur planifikon punën mësimore dhe harton organizimin e orës, në përputhje me përmbajtjen, afinititetet e nxënësve dhe mundësitetë materiale dhe teknike të shkollës (kushtet e hapësirës dhe pajisjes)

Gjatë realizimit të mësimdhënieς sipas programit të shkurtuar, duhet të merren parasysh drejtimet didaktike, dmth. format, metodat dhe aktivitetet e përcaktuara në programin e rregullt, të cilat u referohen përmbajtjeve mësimore të mbuluara nga programi mësimor i shkurtuar. Rekomandohet përdorimi i TIK në çdo segment të procesit mësimor.

4. Normative për personelin mësimdhënës

Programi i shkurtuar e realizon arsimtar në përputhje me normativin mësimdhënës të dhënë në programin e rregullt mësimor

Programin e shkurtuar mësimor për lëndën mësimore Fizikë për klasën e IX(nëntë) të arsimit fillor nëntë vjeçar për vitin shkollor 2020/21 emiratoi

Minister,

Mila Carovska